



PROCESVERBAL II/2023

I mbajtur me rastin e mbledhjes së III (tretë) për vitin 2023 të Komitetit për
Politikë dhe Financa të KK Suharekë

Vendi:	KK Suharekë
Zyra:	Salla e Bordit të Drejtorëve
Data:	22.02.2023
Ora :	13:00

Prezentë:

Z. Bexhet Kuçi - Kryesues

Të pranishëm tjerë:

*z. Urim Suka
znj. Bulëza Kuçi
znj. Sanie Kuçi Rexhepaj
znj. Fidaije Kukaj
z. Dardan Berisha
z. Liridon Fandaj*

Habibe Bytyqi - zyrtare për barazi gjinore
Reshat Reshitaj - Zyrtar për informim
Përfaqësues i OSBE-së
Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

Rend dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për përmbushjen dhe tejkalimin e e planit buxhetor të të hyrave vetanake për vitin 2022,të barten në shfrytëzim në vitin fiskal 2023 ;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e xhamisë në Shirokë;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;**
- 5. Njoftim i planit të zyrës së prokurimit për vitin 2023;**
- 6. Raporti i punës për zyrën e prokurimit për vitin 2022;**

Kryesuesi - me mirëkuptim kërkon që pika 4 të tërhiqet nga rendi i ditës dhe të futet pika tjetër shtesë në rend dite e cila ka të bëjë me formimin e komisionit për mbikëqyrjen e zbatimit të kontratave për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme të Komunës nga përfituesit.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 4 që të tërhiqet nga rendi i ditës.

6 për, 1 apstenim

Tërhiqet pika 4 nga rendi i ditës

Kryesuesi - e hedh në votim pikën shtesë për rend dite.

6 për, 1 apstenim

Miratohet pika shtesë

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës.

6 për, 1 apstenim

Miratohet rendi i ditës

Pika 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet

Pika 2.Shqyrtimi i projekt-vendimit për përmbushjen dhe tejkalimin e planit buxhetor të të hyrave vetanake për vitin 2022,të barten në shfrytëzim në vitin fiskal 2023 ;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - ky vendim a është për mi bartë mjetet apo me shiku a i kemi përmbush?

Kryesuesi - vendimi është për ti bartë mjetet.

Urim Suka - kam vërejt dy gabime teknike dhe është mirë ti përmirësoni. Kur i keni planifiku se ku do ti shpenzoni këto mjete për vitin 2023 ,kërkoj sqarime sepse nuk di si do ta votojmë, sepse bëhemi pjesë e një diçkaje që s'është në rregull.P.sh. keni planifiku projektin rruga "Sherif Aga" në Gjinoc.Kjo rrugë është në kontratë të 2022-tës dhe në raport thuhet që është pagu në 2022.Rruga është dhe në planifikim të 2023-tës.Pse të ndahen tre herë mjete për këtë rrugë? Njejtë është situata edhe në rrugët në Mushtisht.Mua më duket që është keqplanifikim dhe nuk e di se çka po ndodh.Keni nda 7 mijë euro për rrugët"Sadik Shasha","Sadik Sejda"etj në Mushtisht.A mund të kryhen këto rrugë me 7 mijë euro?Për ndërtimin dhe sanimin e rrugëve lokale Sopijë-Vraniq dhe Reqan-Bukosh janë nda 200 mijë euro.

Kryesuesi - faktikisht rruga Sopijë-Vraniq dhe Reqan-Bukosh do të shtrohet risht.

Urim Suka - e kam pa që ajo rrugë ka gropa por është shtruar para katër viteve dhe mendoj që s'ka nevojë me u shtru risht por vetëm të sanohen.

Bulëza Kuçi - sa i përket shumës gati 1 milion eurove tepriçë,Drejtorja e Arsimit a ka paraqit kërkesë se sa mjete i duhen drejtorisë apo janë planifiku aq sa ua ka marrë mendja se i duhen drejtorisë?

Kryesuesi - shpërndarja e buxhetit bëhet në koordinim me drejtoritë.Edhe te D.Arsimit ka pas nevojë.

Labinot Halitjaha - sa i përket rrugëve të Mushtishtit p.sh. rruga Rexhep Velia është rreth 600 metra e gjatë dhe rreth 200-300 metra është lumi ku duhet të bëhet dhe një urë dhe nuk ka buxhet për tu kryer brenda viti. Pasi nuk ka buxhet për tu kryer mbetet si emër vitin tjetër dhe ka mundësi edhe këtë vit mos të kryhet.Mjetet tjera që përmende,kanë qenë të vitit të kaluar,ku në fund të vitit ka qenë i shpallur tenderi por nuk ka konkuru askush dhe mjetet janë bartë prapë për Mushtisht për vitin tjetër.

Urim Suka - komplet kontratën për rrugët në Mushtisht të vitit 2022,asnjërin nuk e ke të shtruar.

Labinot Halitjaha - të dhashë sqarime.

Urim Suka - është dokument që duhet me votu,por ky dokument për mu është i pakuptueshëm.Nuk më dhe sqarime edhe te rrugët tjera në Mushtisht,si Sadik Shasha,Sadik Sejda etj.Nuk i ke në kontratë e as në planifikim të vitit të kaluar.

Labinot Halitjaha - janë rrugë shitesë.

Urim Suka - nëse janë planifikim i ri,e pranojmë por nuk dalin 7 mijë euro.

Liridon Fandaj - shpenzimet komunale te shërbimet publike dhe administrata që janë 24.158.97.Cilat janë shpenzimet për këto dy drejtori që duhet të alokohen mjetet për ti paguar shpenzimet komunale?Ju si ekzekutiv keni dalë suficit për një bartje që e keni bërë të njëjtin vend.Prej bujqësisë i keni sjell te kolektori por nuk i ka pranë ministria dhe keni dal suficit.Cila është arsyeja që për të njëjtën rrugë po i bartni kur është një vendim i ministrisë?

Kryesuesi - punimet do të fillojnë këtë vit për këtë projekt.Shpenzimet administrative janë për rrymë,ujë,mbeturina për administrat dhe shkollat.

Liridon Fandaj - te tabela 1 dhe te drejtorja e shëndetësisë nuk figurojnë 5000 euro,ndërsa te tabela 2 figuron ky investim te shërbimet publike.Nëse është projekt kapital a po bartet te shërbimet publike apo te shëndetësia.

Avni Bytyqi - ky projekt është te kujdesi primar QKMF por nuk qenka në tab.nr.1 te shëndetësia.

Urim Suka - nuk besoj që do ta miratojmë në këtë formë.A mund të kthehet dhe të përmirësohet.

Liridon Fandaj - nëse këto kode janë të 2022-tës,atëherë vendimi është i kundërligjshëm sepse po bëhet bartja për projekte të 2023-tës.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 2.

4 për, 3 kundër
Miratohet pika 2

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e xhamisë në Shirokë;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Liridon Fandaj - a është kërkesë e bashkësisë islame apo e shërbimeve pronësore juridike.

Armend Krasniqi - kemi pas kërkesë zyrtare nga bashkësia islame ku kanë qenë të bashkangjitura disa nënshkrime të qytetarëve të fshatit Shirokë për të caktuar një lokacion që të mund ta ndërtojnë një xhami përmes një donatori.

Liridon Fandaj - mungon kërkesa me nënshkrime të qytetarëve dhe mua më duhet ta di a i keni marrë ato nënshkrime apo vetëm ka ardhë dikush dhe e ka bërë këtë kërkesë.

Armend Krasniqi - kjo kërkesë ka ardhë rreth 6-7 muaj. Kam insistu ta shtyej sepse kemi alternativa të tjera. Ta rregullojmë një park ose një ambulantë më mirë se sa të ndërtojmë kisha dhe xhamia. E kam shty vazhdimisht por po insistojnë shumë. Ligjërisht çdo gjë është në rregull dhe kërkoj falje që nuk është kërkesa me nënshkrime por do ta sjell në Asamble.

Urim Suka - atë që kërkon Liridoni ne e kemi kërku vazhdimisht. Ato materiale që i keni, na sillni edhe neve që ta dimë se çka po votojmë. Ato nënshkrime është dasht me iu bashkangjit lëndës. Nëse kërkesa është me 200 nënshkrime unë ndryshe veproj dhe nëse kërkesa është vetëm me një nënshkrim ndryshe veproj. Nëse ata banorë e kërkojnë, ne ja japim mbështetjen.

Sanie Kuçi Rexhepaj - çka është e planifikuar kjo parcellë me plan zhvillimor dhe harta zonale? A e keni analizu bashkë me inxhinierat që në këtë pjesë mbrapa varrezave, a ka hapsirë të mjaftueshme me u ndërtu Xhamia.

Armend Krasniqi - kemi bashkëpunu me drejtorinë e urbanizmit dhe përgjigja ka qenë që lejohet me u ndërtu dhe parcella duhet me qenë minimum 12 ari.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 3.

6 për, 1 apstenim Miratohet pika 3

Pika 4 shtesë e cila ka të bëjë me formimin e komisionit për mbikqyrjen e zbatimit të kontratave për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Sanie Kuçi Rexhepaj - te zonat industriale sa kam informacion ka qenë një komision prej ekzekutivit që e ka bërë mbikqyrjen e kontratave. Më duket punë shumë me përgjegjësi për këdo që do të jetë anëtar i këtij komisioni për shkak se gjendja nuk është ideale në terren. A do të kontrollohet vetëm kontrata dhe ky komision a është i obliguar të formohet prej Kuvendit apo mjafton prej ekzekutivit siq ka qenë më herët.

Kryesuesi - jo, do të formohet vetëm nga Kuvendi me përjashtim prej një anëtar që me qenë prej ekzekutivit dhe do të jetë Drejtori i Pronës.

Urim Suka - në parim pajtohem por jo kështu në mënyrë të shpejtë si na ka ardhë.

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor jep sqarime rreth formimit dhe kompetencat e këtij komisioni.

Urim Suka - pasi nuk është emergjente, unë nuk e kam gadishmërinë me votu diçka që na ka ardhë kaq shpejtë dhe mendoj ta trajtojmë komitetin e ardhshëm.

Dardan Berisha - ne në KPF mundemi me shtu pika ose me hek. Është e drejtë për me dërgu në Asamble dhe nëse e merr dritën e gjelbër shkon por ka mundësi nuk e voton asnjë anëtar sepse ndoshta është rrezik ashtu si tha edhe Urimi.

Sanie Kuçi Rexhepaj - nëse një kompani kur ka apliku dhe është shpërbly me një kontratë ku parashihet ose supozohet se për dy vite të përfundoj objektin dhe ta funksionalizojë atë. A është kjo detyra e komisionit apo ka edhe detyra ekstra.

Avni Bytyqi - të gjithë operatorët që e kanë marrë pronën në shfrytëzim, njëri prej kushteve kryesore është që në afat prej 1 viti ka qenë i obliguar të paiset me leje ndërtimi. Nga momenti kur paiset me leje ndërtimi, në afat prej dy viteve, duhet ta realizojë investimin. Pra i kontrollon këto dy pika.

Sanie Kuçi Rexhepaj - asnjë anëtar i asamblesë nuk është profesional për këtë komision.

Avni Bytyqi - është Kushtrim Kuçi i cili është arkitekt dhe jeni ju. Ndonjë duhet me qenë edhe jurist.

Sanie Kuçi Rexhepaj - a ka të drejtë me toleru komisioni apo nuk ka të drejtë?

Avni Bytyqi - ti e bën raportin dhe e njofton Kryetarin. Zyrtari ligjor tutje jep sqarime.

Sanie Kuçi Rexhepaj - është punë jashtëzakonisht e madhe dhe mendoj që komisioni patjetër duhet të paguhet. Personalisht nuk kisha qenë anëtare e këtij komisioni.

Liridon Fandaj - në shumicën e kontratave që janë nënshkruar më herët, thuhet që Komuna ka obligim me ja rregullu infrastrukturën. Nëse komisioni shkon dhe e verifikon që dikush nuk ka bërë asgjë dhe e ka një kontratë, arsyetimi i tij do të jetë që Komuna nuk ka bërë asnjë hap rreth infrastrukturë dhe për atë nuk ka investu.

Avni Bytyqi - këto kontrata janë prej viti 2009 deri 2014. 2014 e këndej ky nen nuk ekziston dhe nuk e ka obligim por thotë: Komuna në bashkëpunim me komunitetin e bizneseve nëse gjen fonde do ta rregulloj çështjen e infrastrukturës.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 4.

5 për, 2 apstenime

Miratohet pika 4

Pika 5. Njoftim i planit të zyrës së prokurimit për vitin 2023;

Kryesuesi - i njofton me pikën dhe hap debatin.

Urim Suka - mirëmbajtja dhe pastrimi i autoudhëve është 147.000 euro. Për çfarë rruge bëhet fjalë? Shërbime këshillëdhënëse për legalizime 115.000. A mund të jepni sqarime.

Avni Bytyqi - drejtoria për urbanizëm është duke i grumbullu të gjitha kërkesat për legalizimin e objekteve dhe për këtë duhet të formohet një komision i cili duhet të jetë komision edhe jashtë Komunës për arsye se Komuna nuk ka kapacitete apo burime njerëzore për ta kompletu komisionin si e kërkon ligji.

Urim Suka - për ndërtimin e rrugëve në Grejkoc i keni planifiku 50.000 euro. Kontrata e vitit të kaluar me ata emra nuk është e shtruar asnjë rrugë dhe kur e kam ngrit si shqetësim, asamblisti i Grejkocit ka thënë që është kontratë dy vjeçare dhe shtrohet vitin e ardhshëm. Këtu po del që në Grejkoc ju keni me i shtruar tjera rrugë. Drejtorat nuk janë këtu dhe unë po flas kot.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 5.

5 për, 1 kundër, 1 apstenim

Miratohet pika 5

Pika 6. Raporti i punës për zyrën e prokurimit për vitin 2022;

Kryesuesi - i njofton me pikën dhe hap debatin.

Urim Suka - janë pagu disa rrugë në Grejkoc dhe asnjëra prej këtyre investimeve nuk ka ndodh. Për rrugët në Mushtisht janë pagu 72.000 euro dhe asnjëra nuk është shtruar. Ndërtimi rrugëve në Greiqec, tri vjet kontratë dhe asnjë nuk është e shtruar.

Kryesuesi - e hedh në votim.

4 për, 2 kundër

Miratohet pika 6

Takimi përfundoi: 14:25

Procesmbajtësja:
Dafina Haziraj